



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:042228

Datë: 04.08.2020

Numri i dokumentit: 01048259

P.nr.1011/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Sekretaren Juridike Igballe Arifi, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. K.S nga Vitia, Rruga ...pa nr., dhe 2. E.Hnga Vitia, Rruga” ...” pa nr. , për shkak të veprës penale në bashkëkryerje privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.1640-5/2018 të dt.31.07.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 03.08.2020 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit të dytë E.H, në të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërkaq me datën 04.08.2020, me shkrim përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **K.S** nga Vitia, Rruga ...pa nr., i lindur me ... në Gjilan nga i ati Q... dhe e ëma Q... e vajzërisë S..., i pa martuar, ka të kryer Fakultetin e menaxhmetit , i gjendjes së

mesme ekonomike, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

2. **E.H**nga Vitia, Rruga” ...” pa nr. i lindur me ... në Gjilan nga i ati I... dhe e ëma S... e vajzërisë H..., i pa martuar , ka të kryer shkollën e mesme , punëtor-Kuzhinier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

I akuzuari:

E.H

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 25.02.2018, rreth orës 12:00, në Rrugën e Fshatit Talinoc i Muhaxherëve në Ferizaj, në mënyrë të kundërligjësme e kanë privuar nga liri të dëmtuarin B.Q,të cilin me anë të kërcënimit e kanë futur në veturë dhe e kanë dërguar fillimisht në shtëpinë e të pandehurit të parë, duke embajtur jashtë dëshirës së tijë dhe pastaj vullnetarisht janë dorëzuar në polici dhe pastaj I dëmtuari është liruar,-

Me këte ka kryer vepren penale në bashkëkryerje me të pandehurin e pare K.S Privimi i kundërligjëm i lrisë nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 196 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 31, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

GJYKON

1. E.H

Dënohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 200 eurove (me shkronja: Dyëqind euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 dite pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i denuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj dënimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të dënimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari B.Q nga Prishtina-Lagja ... , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë Ferizaj PP/II nr. 1640-5/2018 të dt.31.07.2018, i ka ngarkuar të pandehurit: 1. K.S nga Vitia, Rruga ...pa nr., dhe 2. E.H nga Vitia, Rruga” ...” pa nr. , për shkak të veprës penale në bashkëkryerje privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 03.08.2020, mbajti shqytimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Ajtene Zoni dhe i pandehuri i dytë E.H,

kurse i pandehuri i parë K.S nuk ka prezentuar në shqyrtim fillestar, ku sipas Policisë së Vitisë i njejti gjindet në botën e jashtme dhe ate në Itali .

Kështu, pas marrjes së mendimit të palëve në shqyrtim fillestar gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së, për të pandehurin e parë K.S ka veçuar procedure penale, për të cilin do të procedohet veçmas dhe me datën 03.08.2020 ka sjellur aktvendim P nr.2011/18 për veçimin e procedurës penale për të pandehurin e parë K.S, kurse për të pandehurin e dytë E.H ka vzhduar me procedurë penale.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që të pandehurit të ytë E.H i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari E.He ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që i ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimin të fajsisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit, janë pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- Të pandehuri kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: Deklarat e të pandehurve dhe e të dëmtuarit dhënë në polici me datën 25.02.2018, Vërtetimi i Sekuestrimit të sendeve dt.25.02.2028, CD dhe Fotografitë, si dhe provat material të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari E.H në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e kanë pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer, por thekson se nuk kanë mundur ti kontrollojnë veprimet e veta në atë moment i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, kërkon falje për këtë veprim të tij dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë ekzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figuren e veprës penale E.H nga Vitea, Rruga” ...” pa nr. , për shkak të veprës penale në bashkëkryerje privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmarrura , është i moshës relativisht të re, të pa martuar. Ndërkaq, rrethana rënduese mori vet peshën e veprës penale, duke qenë i bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave sipas nenit 46 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim më të butë dhe atë dënim me gjobë në lartësi prej nga 200 eurove, ashtuqë, konform nenit 41 të KPRK-së, arrihet qëllimi ndëshkimor.

Nëse të denuarit nuk e paguajnë gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit do ta vuajnë denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, i dëmtuari B.Q nga Prishtina-Lagja ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPRK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën në lartësi prej 30 €, i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të akuzuarit, dhe çështjen penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr.1011/2018 të dt. 03.08.2020

**Sekretarja Juridike,
Igballe Arifi**

**Gjyqtari,
Elmaz Zenuni**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.